



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Komuna e Shtipit

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë së buxhetit themelor (637)

Qëllimi i revizionit: Nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet, informacionet dhe transaksionet financiare janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- parregullsi në dokumentacionin e ndërtimit dhe vënien në përdorim të ndërtimeve pa kryer kontroll teknik;
- me programet janë paraparë projekte pa indikator vlerash;
- janë bërë pagesa për aktivitete të cilat nuk janë paraparë me programet;
- kontroll i pavendosur i realizimit të aktiviteteve programore nga NP dhe shpenzimin e mjeteve të ndara për klubet sportive dhe organizatave jofitimprurëse;
- janë kryer prokurime të shërbimeve për produksion pa dokumentacion mbështetës;
- evidenca e pa vendosur e prokurimit dhe shpenzimit të vajit ekstra të lehtë për ngrohje.

Mendimi i dhënë*:



Mendim të pavolitshëm në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore.

Rekomandimet kyçe:

- sigurimi i dokumentacionit të plotë për punët e përfunduara ndërtimore dhe respektimi i procedurave të paraparë me Ligjin për ndërtim
- përcaktimi i indikatorëve të vlerës së projekteve në programet dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit të realizimit të programeve
- kryerjen e kontrollit të përdorimit me dedikim të mjeteve të ndara për NP, klubeve sportive dhe organizative jofitimprurëse
- pagesën e faturave vetëm në bazë të dëshmimeve të paraqitura për shërbimin e vërtet të kryer
- vendosjen e evidencës së shpenzimit të vajit ekstra të lehtë për ngrohje

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Nuk janë marrë vërejtje për draft-raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 26-121/10 nga 07.09.2022.

* pozitive me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur